

GAZETA Jeta në Kosovë

[BALLINA](#) [PROFIL](#) [POLITIKË](#) [KOMUNITET](#) [EKONOMI](#) [KULTURË](#) [KOLUMNË](#) [PJESËMARRJE](#) [EMISIONE](#)

[Ambient](#) [Shoqëri](#)



Visualizimi i Parkut të Erës në Zatriç | Foto: NEK

nga **Petrit Çollaku**
Prishtinë | Janar 30, 2013 | 12:23

Kompania zvicerane Upwind International I GmbH do të instalojë 15 mullinjtë e erës në Zatriç të Rahovecit për të prodhuar rrymë elektrike, në një projekt ku ajo llogarit të investojë deri në 60 milionë euro. Në vendimin e kompanisë për të përzgjedhur vendin e investimit, ka luajtur rol edhe infrastruktura e përshtatshme.

Upwind International I GmbH ka zgjedhur lokacionin afër fshatit Zatriç të komunës së Rahovecit për të instaluar mullinjtë e erës për prodhim të energjisë elektrike.

Matjet i ka bërë kompania NEK Umwelttechnik AG, pjesë e NEK Group AK që përfshinë edhe Upwind International, gjatë katër viteve të shkuara në Kosovë.

Kompania ka vendosur se lokacioni më i mirë është në afërsi të Zatriçit.

"Ky vend është zgjedhur në bazë të matjeve tona të erës të cilat i kemi bërë këtu nga një kullë GSM për më shumë se tri vite", tha Christoph Kapp, person zyrtar i Upwind International, dega në Kosovë.

Pas rezultateve premtuese, kompania kishte instaluar një kullë të gjatë 60 metra ku tani bëhen matjet e kushteve të ajrit.

Zyrtari i kompanisë Kapp tha se, përveç të dhënave premtuese të erës, ishin edhe disa faktorë të tjerë që kanë ndikuar në vendimin për zhvillimin e projektit në Zatriç.

"Nuk ka ndalesa mjedisore, nuk ka zona të zogjive, pranim i lartë i projektit nga komuna, qasje relativisht e mirë nga rrugët ekzistuese, pa punë shtesë civile për rrugët me qasje, rrjeti elektrik në afërsi me kapacitet dhe vende rezervë dhe stabiliteti i rrjetit", shtoi Kapp.

Ai tha se ende nuk është vendosur se cilat tipe të turbinave (gjeneratorëve) do të vendosen, por se projekti do të jetë i përbërë nga 15 turbina të madhësisë prej 2 deri në 3 megavatë.

"Prandaj, vargu i instaluar i kapacitetit elektrik është 30 - 45 MW. Shpejtësia e erës në qendër të turbinave pritet të jetë rreth 6.5 deri në 6.9 metra për sekondë, varësisht prej lokacionit të saktë të turbinës", shpjegoi Kapp.

Kompania pritet të investojë diku 55 deri në 65 milionë euro, varësisht nga madhësia e turbinave.

"Deri më sot, ne kemi investuar për zhvillimin e këtij projekti në Kosovë përafërsisht 950,000 euro, të paguara nga burimet tona", tha ai.

Gefällt mir

14.209 Personen gefällt das. [Registrieren](#), um sehen zu können, was deinen Freunden gefällt

search..

LAJMET E FUNDIT

Arrestohen Pesë Veta Për Dëmtimin e Varrezave Serbe



15:30 PM- Policia e Kosovës arrestoi pesë persona, nën dyshimet për vandalizimin...

Policia Suspendon Dy Policë për Rastin e Aleksandër Vulinit



12:53 PM- Pas hetimeve të EULEX-it dhe inspektoratit policor, policia ka...

Arrestohen Fallxhinjtë Mashtrues



11:58 AM- Katër gra dhe një burrë, shtetas të Shqipërisë, janë ndaluar nga...

Theret me Thikë Një 20-Vjeçar

Jahjaga: Dialogu Alternativë e Vetme

Kërkimfalja nga Gjenerali Jugosllav "Vendimtare"

Dyshohet se Është Vetëvrarë Hamdi Sopa

Policia e Lejoi Autobusin e Stërbushur e Pa Regjistrim

[Të gjitha](#)

KOLUMNË

Albana Beqiri

I Çmenduri Që Çmend Një Vend



nr. komenteve 2

Me të lexuarat

Kongresi i Thaçit

Lapidaromania e Kapitalistëve Politikë të Prishtinës dhe Beogradit

E Do Thaçin Pa Interes

"Nuk Derdhim Gjak për Lapidar"

Propozohet Dekorimi i Politikanëve të Akuzuar

Me të komentuarat

Interesim Më i Madh në Ujë

Ndërtimi i projektit mund të fillojë vetëm kur Zyra e Rregullatorit të Energjisë në Prishtinë, ZRrE, do të lëshojë autorizimin për këtë punë.

Ky institucion është duke shqyrtuar kërkesën e kompanisë zvicerane. Upwind ka aplikuar më 30 tetor 2012 në ZRrE ndërsa ka kryer edhe obligimin ligjor që të bëjë publik interesimin e saj në këtë projekt në gazetën e përditshme kosovare në rast se dikush ka ndonjë vërejtje eventuale lidhur me aplikacionin.

Bordi i ZRrE-së do të ketë takim gjatë muajit shkurt dhe do ta shqyrtojë aplikacionin e kompanisë duke lëshuar fillimisht "autorizimin preliminar".

"Në shkurt do të shohim nëse kompania ka siguruar kontratën me KEK, lejet përkatëse nga ministria e mjedisit, lloji i turbinave dhe nëse ka ankesa nga popullata lokale atje", tha Afrim Ajvazi, udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe të Liçencimit në ZRrE.

Ai tha se pas kësaj procedure, kompania mund të licencohet për ndërtimin e kapaciteteve të saja.

Sipas regjistrimit të ZRrE-së, janë edhe katër kompani tjera private që presin të autorizohen për ndërtimin e kapaciteteve të reja për gjenerimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme.

"Edelwiess Energy", "Matkos Group", "RIMED" dhe "Triangle General Constructors" janë në pritje të autorizimit. Të tri kompanitë do të investojnë në ndërtimin e hidrocentraleve të vogla.

Ndërsa, pesë kompani tjera kanë fituar autorizimin preliminar po ashtu në projektet me hidrocentrale.

Kompania e parë që kishte instaluar tri mullinjtë e erës në vitin 2008 është Wind Power e cila pas ndërtimit të kapacitetit kishte bërë shkyçjen e turbinave nga rrjeti i KEK-ut për shkak të mosmarrëveshjeve me ZRrE-në.

Wind Power nuk kishte pranuar që një MW ti blihet për 48 euro nga KEK-ut tarifë kjo e caktuar nga ZRrE-ja. Kjo e fundit kishte thënë në atë kohë se kompania gjermane kishte sjellë gjeneratorë të përdorur ndërsa tarifa nxitëse prej 84 euro për MW është për investimet që sjellin gjeneratorë të rinj.

Wind Power kishte instaluar tre mullinjtë e erës në Golesh, në afërsi të Prishtinës.

Kosova në Traktatin e Athinës

Ministria e Zhvillimit Ekonomik mirëpret investimin e zviceranëve duke u bazuar edhe në cakun që ka Kosova që duhet të arrij për gjenerimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme.

Kosova është nënshkruese e Traktatit të Athinës dhe duhet të përmbushë zotimet e saja prej 25 për qind të prodhimit të energjisë nga burimet alternative dhe duhet të arrij këtë deri më 2020.

"Në Kosovë, rreth 2 për qind e energjisë elektrike prodhohet nga BRE (burimet e ripërtëritshme)", tha Bedri Dragusha, Agjencia Kosovare për Eficiencë të Energjisë, në kuadër të MZHE-së.

Traktati i Athinës është nisur nga Bashkimi Europian me qëllimin e krijimit të parimeve dhe nevojave institucionale për zhvillimin e tregut regional të energjisë në Europën Jug-Lindore.

Ai tha se investimi i zviceranëve mund të furnizojë përafërsisht 54 deri në 81 familje bazuar në konsumin mesatar të një familje e cila është 55 kWh.

Korporata Energjetike e Kosovës, KEK, prodhon brenda ditës rreth 20 mijë megavatë, apo rreth 800 megavatë/orë.

KEK është e orientuar në prodhim të energjisë nga termocentralet. "Sa i përket investimeve në forma alternative, ju lutem drejtoju MZHE-së", tha Viktor Buzhala, zëdhënës i KEK-ut.

Qeveria e Kosovës ka në planin e saj që të ndërtojë edhe një termocentral të ri "Kosova e Re" me kapacitet prej 600 MW.

Teknologjia e Kompikuar
Për Policinë

Njomza Salih

Të Rritesh dhe Argëtohes

Donjeta Demolli dhe Mihane Mustafa

E Do Thaçin Pa Interes

Liridona Hyseni

Prishtina Ka Legalizuar Vetëm 100 Objekte

Njomza Salih

BE Kundër Diskutimit Parlamentar të Rastit Kjiçina

ANKETË**A E DËMTON PDK-NË MUNGESA E KRASNIQIT DHE LIMAJT NË KONVENTËN E SAJ?**

Jo

Nuk ka rëndësi

Mbetet partia më e madhe

Po

Koncentrohet më tej tek lideri

Freskohet me emra të rinj

PDK mund të humbë vota

Partia mund të çahet

Shiko arkivën

Voto

FOTOGALERIA**PROTESTE DHE MASA SIGURIE****KARIKATURA**

Shiko arkivën





Foto ilustrim | flickr.com

Ndërkohë, konzorciumi i organizatave jo-qeveritare KOSID kundërshton këtë plan. Konzorciumi thekson se Kosova ka mjaft qymyr për të mbuluar nevojën bazë të kërkesës për energji elektrike.

Anëtarët e konzorciumit thonë se së pari në sistemin energjetik të Kosovës duhen të zvogëlohen humbjet teknike dhe ato komerciale, ku të dyja arrijnë afërsisht 40 për qind të energjisë së prodhuar.

“Kosova duhet të investojë në energji të ripërtëritshme për t’i arritur zotimet para Komisionit Europian, ku diku 20 për qind e energjisë duhet të jetë nga energjia alternative. Qeveria duhet po ashtu të forcojë programet e eficientës së energjisë elektrike, të cilat do të kishin ndihmuar në zvogëlimin e kërkesës për energji pasi këto masa të jenë implementuar”, tha Nezir Sinani, anëtar i KOSID-it.

Sinani po ashtu thotë se Kosovës i nevojitet interkoneksioni në linjat e tensionit të lartë që të funksionojë me shtetet fqinje për të mundësuar shkëmbimin e energjisë elektrike mes vendeve.

“Një sistem i tillë mungon me Shqipërinë”, tha ai.

“Në rast të ndërtimit të një termocentrali të ri, të gjitha këto kritere do të bien në ujë dhe ne do të përballemi edhe me një termocentral qymyri për së paku 40 vitet e ardhshme”, shtoi Sinani.

Email

Print

Share

Tweet 0

Gefällt mir 0

Komentet: Komentet sipas rendit kronologjik (Gjithsej 0 Komentet)

Emri:

Komenti:

8360

Kodi:

Karaktere të mbetura: 1000

Komento

Heqje e përgjegjësisë

Ndalohen të gjitha shkrimet dhe komentet që përmbajnë gjuhë diskriminuese, denigruese, të urrejtjes apo të nxitjes së veprimeve kriminale. Gazeta Jeta në Kosovë rezervon të drejtën e publikimit ose jo të shkrimeve dhe komenteve. Përmbajtja e komenteve në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të redaksisë.

BIRN

Rreth nesh

Kontakti

Twitter

facebook

flickr

youtube

RSS News

REGJISTROHU PER NEWSLETTER

Dërgo

© Të gjitha të drejtat e rezervuara

